

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË "ARVI INVEST"**

Sot ne dt. **08 Shkurt** 2021 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",

**ERVIS IMERAJ**, i biri i **ARJAN** i datelindjes **20-01-1988**, i lindur ne Fier dhe banues Fier,lagj.L.KONFERENCA E PEZES.15 KATESHI FIER , shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.Personal **180120084A** ,leshuar nga MB Tirane me date **14-10-2020**, i cili me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijone shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin "**ARVI INVEST**"

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezqatja,Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**ARVI INVEST**" Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria "**ARVI INVEST**", eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "**ARVI INVEST**", eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

**Shoqeria e ka seline ne adresen:**

**Lagja, Rr Mujo Ulqinaku,Nd.39,H7,Fier,9305 .**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 4

**Objekti i veprimtarise**

**Te shtojë veprimtarine e biznesit ne fushen e ndertimit te objekteve rezidenciale dhe jorezidenciale. Rikonstruksion objektesh. Germime dheu dhe kanalizime. Shtrim i linjave te ujesjellesit, gazsjelles. Shtrim dhe asfaltim rrugesh.Transport i produkteve dhe mallrave industriale, makineri e pajisje, per vete dhe per te tretet. Import-eksport, tregtim me shumice dhe pakice i mjeteve dhe artikujve te ndryshem industriale.**

**Transport mallrash me mjete jashte norme.**

Neni 5

Kohezqatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke



filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

KREU II  
KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100,000** lekë.

Kapitali i shoqerise eshte **100,000** leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortaku i shoqerise si me poshte :

1. Ortaku Themelues: **ERVIS IMERAJ**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme **100,000** Leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise, Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar **100,000 Leke**  
Vlera Totale e Kapitalit te Paguar **100,000 Leke**, do te paguhet ne avance nga ortaku i vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vlenen e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem, i cili do te jete **ERVIS IMERAJ**, i biri **ARJANIT**. i datelindjes **20-01-1988**, i lindur ne Fier dhe banues Fier, lagj. **KONFERENC PEZES**, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr. Personal I80120084A. ,leshuar nga MB Tirane me date **14-10-2020**

Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfarëdo formë qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzues apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

#### Neni 11

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe dhe per çfare do shkakut, edhe para plotesimit të afatit per të cilin është krijuar siç mund të jone

a. Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshëm të veprimtarisë së saj.

b. Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c. Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqëri ne likuidim e siper ".

#### Neni 13

##### Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfare do ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperisë.

#### Neni 14

##### Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italiane dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqërisë tregtare "ARVI INVEST", nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

### **ORTAKU I SHOQËRISË**

Ervis Jmeraj

